




Republika e Kosovës
Republika Kosova



Komuna e Vitisë
Opština Vitina

DREJTORIA E INSPEKSIONIT

Nr.01

Datë: 24.02.2022

PLANI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022

Ky plan paraqet aktivitetet e Drejtorisë së Inspeksionit (në vazhdim D.I.) për periudhën kohore janar-dhjetor 2022, të cilin ju përcjellim zyrës së kryetarit të komunës së Vitisë, ashtu siç kërkohet, sipas mandatit, kompetencave dhe përgjegjësisë të D.I.

Plani i punës së D.I për vitin 2022, përmban të gjitha objektivat dhe aktivitetet gjatë periudhës kohore janar –dhjetor 2022.

Drejtoria e Inspeksionit është organ lokal i përcaktuar me nenin 56 të statutit të Komunës së Vitisë të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, e i cili ka hyrë në fuqi më 21.04.2011, fushëveprimtaria e së cilës është përcjellja, monitorimi dhe marrja e masave, përmes vendimeve, konkluzioneve administrative dhe gjobave në funksion të mbykëqyerjes inspektuese, të fushave të rregulluara me ligje, akte nënligjore, vendime dhe dispozita tjera ligjore në fuqi.

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Inspeksionit, është e organizuar në:

1. Sektori për Inspektime, që përfshin udhëheqësin e sektorit,
2. Inspektori i mbrojtjes së Ambientit
3. Inspektori i Shërbimeve Publike
4. Inspektori i Komunikacionit
5. Inspektorët e ndërtimit (Dy inspektor)
6. Inspektorët e tregtisë (Dy inspektor) dhe
7. Gjeodeti (Zyrtaari për matje, rrjet dhe gjeometër)

Mbetet sfida organizimi i stafit dhe drejtorisë, presim rekrutimi gjatë fillimit të vitit 2022 me pozitë të cilat janë të lira Inspektor i shërbimeve publike, dhe Inspektor i ndërtimit, nga data 01.08.2021 tre punëtor apo pozitë: Inspektori Sanitar, Inspektori i Veterinës dhe Inspektori i Bujqësisë kanë kaluar në Agjensinë e Ushqimit dhe Veterinës, agjensi e cila funksionon në kuadër të zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu sfida e madhe mbetet edhe mungesa e paisjeve teknike, dhe automjeteve të cilat janë të domosdoshme për realizimin e punës në D I.

UDHËHEQËSI E SEKTORIT PËR INSPEKTIME

Ky sektor në kuadër të drejtorisë për inspeksion, udhëhiqet nga Udhëheqësi i Sektorit për Inspektime, ku përfshin inspektimet për shërbime publike, ambient dhe komunikacion si dhe uzurpimet e pronës komunale dhe i cili në kuadër të plan-programit të punës dhe autorizimeve që ka sektori udhëheqë, mbykëqyrë dhe organizon punët dhe inspektimet në përputhje me dispozita ligjore pozitive.

Udhëheqësi për inspektime është i angazhuar në inspektim në teren duke u marrur në veçanti me kompletimin e lëndëve në lëminë e uzurpimeve të tokës në pronësi publike-komunale, pranimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarve dhe institucioneve tjera nga fushveprimtaria e sektorit.

Gjatë punës së ushtrimit të detyrës zyrtare pranimi i kërkesve dhe ankesave të qytetarve dhe institucioneve për raste të uzurpimit të pronës publike dhe monitorimi apo përcjellja e gjendjes së bashku me inspektor vazhdojnë me inspektime dhe me procedurat e metutjeshme.

I njëjti sektor mirret me lirim të pronës së uzurpuar publike dhe lirim të hapësirave publike, si dhe duke vazhduar procedurat me qëllim të relizimit të investimeve në infrastruktur publike nga ana e institucione kumunale, bazuar në planin e mobilitetit të miratuar nga Kuvendi Komunal i Vitisë. Gjithashtu kujdesë të veçantë, do ti kushtojmë edhe kërkesës për zhvillimin e procedurës penale, për gjithë ata të cilët kanë uzurpuar pronën publike.

Natyrisht për tu përmbushur planprogrami i paraparë, në shkallë sa më të lartë, duhet të ekzistojnë kushte dhe përkrahje jo vetëm nga drejtoria dhe eprori i saj, por në shkallë më të gjërë, dmth.edhe nga strukturat komunale, për ekzekutimin e lëndëve të plotëfuqishme, gjithashtu duhet siguruar zyrtarin për gjeodezi për shkak të matjeve në terren dhe që do ti shërbej vetem kësaj drejtorie.

INSPEKTORI I MBROJTJES SË MJEDISIT

- Përcjellja e higjenes në qytet në mënyrë kontinuele.
- Inspektimi i vazhdueshëm për vlersimin e gjendjes në mjedis.
- Verifikimi i aktiviteteve ndotëse të cilat janë evidentuar.
- Inspektimi i të gjitha rrjeteve të kanalizimit në Komunën e Vitisë, lidhur me ndërtimin e gropave septike të parapar sipas PZHK,PZHU,në ato lokalitete ku mungojnë.
- Ndalimim i bartjes të mbeturinave nga kompanitë e pa licencuara dhe zbrazja e tyre jasht standardeve.
- Inspektimi i veprimtarive që duhet ti nështrohen ndikimit të gjendjes në mjedis.
- .Implementimi i Ligjit mbi Mbrojtjen e Mjedisit dhe Rregullores për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Zgjidhja e probleme mjedisore për të gjithë komunitetet.
- Zbatimi i Urdhëresës për Gjoha Mandatore.
- Implementimi i planit Operativ për Menaxhimin e mbeturinave në qytet.
- Ndalimi i prerjes dhe krasitjeve të drunjëve në qytetet pa leje paraprake.
- Mbikqyrja e hapësirave të gjelbrura.
- Mikqyrja e Zbatimi të Planit Zhvillimor Komunal në fushen Mjedisore.

- Implementimi i Udhëzimit Administrativ dhe Rregullores Komunale për Lejet Mjedisore Komunale .
- Inspektimi i hapësirave (oborreve) të shkollave lidhur me mirëmbajtjen e pastërtisë dhe zgjidhjes së problemit me ujëra të zeza.
- Ndalimi i shfrytëzimit të gurëve, rërës, dheut nga shtretërit dhe brigjeve të lumenjve në ato pjesë ku është kompetent inspektori komunal i mjedisit.
- Takim me Kryetaret e fshatrave , lidhur me iniciativat për probleme mjedisore.
- Shënimi i Ditës së Planetit Tokë 22 Prilli.
- Shënimi i Ditës së Mjedisit 5 Qershori.
- Akcioni i eliminimit të plehërave të kafshëve në vende publike dhe dalimi i hedhjes së tyre.
- Inspektimi lokaliteteve që posedojnë rrjetë të kanalizimit me qëllim të detyrimit të kyqjes për personat që ende nuk janë kyq. Inspektimi i tregjeve të kafshëve me qëllim të ndalimit të therrjeve të kafshëve në hapësirë.
- Inspektim ambulantave dhe barnatoreve shëndetësore lidhur me menaxhimin e mbeturinave sanitare.
- Inspektimi i thertoreve lidhur me menaxhimin e mbeturinave nga therrjet e kafshëve
- Bashkëpunimi me inspektorët e nivelit qendror , lidhur me kordinimin e aktiviteteve në fushën e mjedisit.
- Përcjellja e trajnimeve dhe aktiviteteve tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.
- Jemi në mbikqyrje të Marrëveshjes së mirkupimit dhe bashkfinancimit nga ana e Komunes së Vitisë dhe ambulancave veterinarike në Viti për trajtimin e qenëve endacak.

INSPEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

- Kryen inspektime me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike (rrugëve, trotuareve, shesheve, parqeve, varrezave, shëtitoret, sipërfaqet e gjelbëruara dhe sipërfaqe tjera publike) nga dëmtimet, keqpërdorimet dhe shfrytëzimet e paautorizuara;
- Bën verifikimin e dokumenteve burimore, të cilat shfrytëzuesit e hapësirës publike duhet t'i posedojnë, sipas ligjeve përkatëse dhe rregulloreve komunale;
- Ndërmerr masa ndëshkuese ndaj shkelësve të ligjeve përkatëse dhe rregulloreve komunale, harton kërkesat për fillim të procedurës kundervajtëse dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave për të cilat është i autorizuar;
- Inspekton punimet e të gjithë operatorëve ekonomik/ndërmarrjeve, në sipërfaqet publike;
- Kryen mbikëqyrje inspektuese me qëllim mbrojtjen e sipërfaqeve publike, mbikëqyrë mirëmbajtjen e pastërtisë në sipërfaqet publike, nyjat sanitare publike, bartjen, deponimi dhe trajtimi i mbeturinave, përcjellja, trajtimi dhe pastrimi i ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike, gjelbërimin, ndriçimi publik, tregjet, furnizimi me ujë-ujësjellësi, furnizimi i lagjeve me energji termike, rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave;
- Kryen dhe detyra tjera të përcaktuara me ligj dhe akte tjera nen ligjore;

INSPEKTORI I KOMUNIKACIONIT

Për planin e punës për vitin 2022, kemi paraparë këto objektiva:

- Zbatimi i Ligjeve dhe Rregulloreve në fuqi si:
 1. Ligji i Transportit Rrugor Nr.04/L-179
 2. Ligji i transportit për mallra të rrezikshme Nr.2004/6
 3. Ligji i Trafikut Nr.05/L-088 si dhe
 4. Rregullorja Komunale për Organizimin e Transportit Brenda Komunës së Vitisë, Me Nr.01-013/764 , të datës 31 Maj 2014.
 5. Vendimi për rregullimin e Komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e sajë, me Nr.01-013/372 të datës 04.04.2017, Krijimi i kushteve më të mira për një qarkullim më të sigurt dhe të lirë në Komunikacion.

Gjithashtu kemi paraparë koordinimin e bashkëpunimit me institucionet gjegjëse si:

- a. Policinë e Kosovës, Stacioni Policor në Viti e Kllokot, dhe Njësinë e Trafikut në Gjilan
 - b. Gjykatën Themelore në Gjilan dega në Viti, Departamenti për Kundërvajtje .
 - c. Kolegjet nga Rajoni, si Ferizaji, Kaçaniku, Gjilani etj.
 - d. Bashkëpunimi me komunitetin dhe shoqëritë civile.
 - e. Koordinimi i Veprimeve me Ministrinë e Infrastrukturës si dhe Inspektorët Rajonal
 - f. Bashkëpunimi me Operatorët e Transportit Publik dhe të Mallrave.
 - g. Me përfaqësuesit e Auto-shkollave etj.
- Në kudër të kompetencave dhe përgjegjësisve tona kemi paraparë edhe planifikimin rreth furnizimit dhe vendosjes së Shenjave Vertikale dhe Horizontale të Komunikacionit.

- a) Furnizimi me Shenja adekuate për rrugët e reja
- b) Mirëmbajtja e shenjave në rrugët ekzistuese.

Për shkak të dinamikës së punëve këto veprime i kemi ndarë nëpër faza dhe atë:

- Faza e parë nga Janar deri në Prill
- a) Intensifikimi i aktiviteteve rreth licencimit të kompanive të transportit publik dhe të mallrave, ku në rastet e veçanta do të marrim masa konformë ligjeve dhe rregulloreve në fuqi të parapara për këtë lloj veprimtarie.
- Faza e dytë nga muaji Prill deri në Qershor
Kryesisht për këtë fazë kemi paraparë aktivitete rreth vendosjes së sinjalizimeve vertikale dhe horizontale të shenjave të Komunikacionit, gjithashtu kontrollimi i transportit Publik dhe të mallrave do të vazhdoj në mënyrë kontinuele.
- Faza e Tretë nga muaji Korrik deri në Shtator
Kjo është faza më dinamike në komunikacion ngase kemi një fluks më të shtuar të automjeteve nga mërgimtarët ,si dhe sezona e pushimeve verore, Gjithashtu komuna e Vitisë bënë përgatitje të veçanta për organizimin e festës së zojës së madhe në Letnicë.
Po në këtë fazë kemi përgatitje të veçanta për organizimin e transportit të nxënësve për tërë territorin e Komunës së Vitisë.
- Faza e Katërt Nga Tetori deri në fund të Vitit pra në Dhjetor:

Tani në këtë fazë fillon përgatitja për sezonin dimërore, ku do të bëjmë identifikimin e nevojave për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, dhe planifikime të veçanta rreth mirëmbajtjes dimërore të rrugëve publike në komunën e Vitisë.

INSPEKTORËT E NDËRTIMIT

Plani vjetor hartohet në bazë të “Ligji të Ndërtimit”, me Nr.04/L-110 të Kuvendit të Kosovës të datës:31 Maj 2012.

Kontrollimi i ndërtimeve të larta dhe të ulëta në territorin e komunës së Vitisë, bazuar sipas planit Zhvillimor Urban të komunës sonë.

Masat preventive për të gjitha objektet të cilat fillojnë që të ndërtohen

Pa leje përkatëse të ndërtimit nga organi kompetentë.

- Evidentimi i ndërtimeve me leje ndërtimi apo pa të në qytetin e Vitisë dhe periferi.
- Kontrollimi i kompanive të ndërtimit se a janë të licencuar, dhe se a i kanë të gjithë Stafin dhe mekanizmin përkatës për lëmit e ndërtimit.
- Implementimi i këtij plani është ndarë në 4 (katër) faza, dhe atë:
 - Faza e parë Janar – Mars, në këtë fazë kryesisht fillojnë përgatitjet për ndërtime pranverore, por si ngecje do të jenë kushtet atmosferike, por ne do të jemi në vëzhgim të terrenit.
 - Faza e Dytë – Prill-Qershor, do të shtohet aktiviteti i kontrollimeve të ndërtimit në teren, në të gjitha hapësirat në komunën e Vitisë.

Gjatë kontrollimeve do të verifikojmë objektet në ndërtim të cilat posedojnë leje ndërtimi, dhe ato të cilat nuk posedojnë leje ndërtimi do të merren masa paraprake të parapara me Ligjet e ndërtimit dhe rregulloret të cilat janë në fuqi.

- Faza e Tretë – Korrik – Shtator, Gjithashtu do të vazhdojmë aktivitetet në mënyrë të vazhdueshme, për arsye se ndërtimet vazhdojnë me të njëjtin intensitet të ndërtimeve.

Për të qenë më efikas në zbatimin e këtyre aktiviteteve kemi paraparë një bashkëpunim me Policinë e Kosovës, dhe Gjykatën Themelore në Gjilan dega në Viti, Përmes Prokurorisë Themelore në Gjilan, si dhe me Drejtoritë të cilat kanë qasje në këtë lëmi, si ajo e Bujqësisë, Urbanizmit, dhe Pronës.

- Faza e katërt – Tetor-Dhjetor,

Gjatë kësaj faze ku fillon të reduktohet numri i ndërtimeve, herë pas here do të bëjmë kontrollime vazhdueshme, dhe do të verifikojmë ndonjë rast të ndërtimit të ri, varësisht nga kushtet atmosferike.

Dhe në fund do të bëjmë verifikim e të gjitha dokumenteve si Procesverbaleve, Vendimeve, Njoftimeve etj,

Për zbatimin e këtij plani domosdoshmërishtë janë kushtet themelore: si Vetura, pajisjet teknike, si dhe përkrahja nga institucioni komunal, të cilat janë cekur edhe më lartë.

Në këtë vit parashohim që të bëjmë evidentimin e të gjitha ndërtimeve, të cilat janë ndërtuar pa leje përkatëse të ndërtimit sidomos në zonat e ndaluara për ndërtim si dhe në pronat shoqërore.

Në zonat ku ndërtimi është i lejuar neve do të bëjmë trysni që palët me doemos të pajisen me leje përkatëse të ndërtimit.

INSPEKTORËT E TREGUT

- Detyrimi i bizneseve për legalizimin e veprimtarisë pranë zyrës së biznesit në Viti në pajtim me nenin 6 të ligjit 2004/18.
- Organizimi i kontrollimeve për evidentimi dhe detyrimin e rexhistrimit të biznesit të disa veprimtarive të cilat ushtrojnë biznes në vende të pa përcaktuara në Seli, si ndërmarrjet transportuese, ndërtime, shëndetësore, shpeditore, ndërmjetësim dhe shtije në dere si dhe veprimtarive shërbyese e argëtuese të cilat ushtrojnë veprimtari në orët e vona të ditës.
- Kontrollime mbi cilësitë, çmimet dhe kushtet e shitjes me çmime në aksion dhe me shitje me çmime në lirim në të gjitha lokalitetet.
- Kontrollime mbi prejardhjen e mallit fletgarancionet dhe atestet si dhe kushtet e ne të cilat ofrohet garancinë përkatëse dhe respektimi i tyre.

- Detyrimi i pajisjeve me pranime teknik te lokalit nga komisioni per pranimin teknik te lokalit varësisht nga natyra e veprimtarisë dhe kushteve të biznesit.
- Kontrolle ne transportim dhe bartje te mallit e cilat mund te behet ne bashkëpunim me inspektorët tjerë dhe organet e autorizuar.
- Kontrolle dhe mbikëqyrje për dhënien e faturave apo bllok paragonave ne tregëtin me pakicë dhe shumice si dhe ne objektet ku behet servsim i shërbimeve ,si dhe mbajtja e rregullt e tyre ne lokale ku ushtrohet biznesi
- Kontrollimi i kushteve teknike ne lokalet dhe mundësia e evidentimit dhe përmirësimit te kushteve ne ruajtje dhe deponim e transport te mallit.
- Detyrimi i bizneseve për shpallje te orarit te punës dhe mbishkrimit te firmës.
- Kontrollime varësisht nga urdhëresa e kryeinspektorit ne MTI .
- Kontrolle dhe verifikim te njërive matëse , zhigosja e tyre sidomos ne veprimtarit tek argjendarët dhe mullirit elektrik
- Verifikimi dhe kontroll mbi zbatimin e njërive matëse si dhe peshës se deklaruar te prodhimeve te ofruara nga prodhuesit si bukëpjekësit dhe ofruesit e shërbimeve tjera në tregti.
- Ndalimi dhe asgjësimi i mallrave qe shkaktojnë dëme dhe rrezik për shëndetin jetën dhe mjedisin e konsumatorëve , si dhe asgjësimi i tyre se bashku me inspektorët tjerë përkatës
- Kufizimi dhe ndërprerja e veprimtarive te rrezikshme dhe te ndaluara , te cilat përbejnë rrezik për jetën shëndetin e qytetareve
- Dhënie e këshillave , dhe njoftimeve të të gjitha palëve mbi procedurat dhe ligjet ne fuqi

GJEODETI (Zyrtar per matje, rrjet dhe Gjeometer)

Detyrat e Gjeodetit parashihen të ndihmoj në hartimin dhe zhvillimin e planeve të punës në pajtim me mbikqyrësin për zbatimin e detyrave të percaktuara në bazë të objektivave të njësisë dhe jepë rekomandime lidhur me realizmin e objektivave.

Bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të mbrendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirsim me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësis së punës.

Kryen matjet dhe përpunimin e të dhënave si dhe llogaritjen e kordinatave të matjeve kontrollimin e tyre me kushtet e bazave gjodezike.

Percjell të gjitha ndrrimet në sipërfaqen e tokes duke harmonizuar gjendjen reale ne terren me gjendjen ne plane dhe operativat kadastrale.

Bënë perkufizimin e zonave kadastrale dhe merr pjes ne pergaditjen e terenit per matjet e reja.

Merr pjes ne plotsimiet e rrjeteve egzistuese dhe bazave gjodezike si dhe regullon dhe regjistron shenimet origjinale te matjeve dhe te objekteve.

Bene ndrrimin e kulturave të parcelave, ndarjën e parcelave dhe bashkimin e parcelave dhe matjen e ndertesës.

Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

24.02.2022



Drejtoria e Inspeksionit

[Handwritten signature]

Drejtori: Adnan Imeri